



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 832/1 Prot

Tiranë, më 29/4 /2022

VENDIM

Nr. 10, datë 29. 4 .2022

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 892 Prot., datë 28.04.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Kulturës” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuarit, ankuesja, me e-mail-in datë 15.04.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni mbi *çështjen e përkeqësimit të strukturës së Urës së Matit- Trashëgimi Kulturor*, konkretisht:

1. A është ngritur ende grupi i ekspertëve ndërsektorial, që do të identifikojnë shkaqet dhe pasojat e demtimit dhe do të ndër marrin masa për eliminimin e tyre?
2. Nëse është ngritur ky grup ekspertësh, a kemi ende një nismë konkrete të ndërmarrë nga këta të fundit, dhe cila është ajo?

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstaton se ankesa, është depozituar pranë Zyrës së Komisionerit 3 (tre) ditë pune, përpara përfundimit të afatit të vendosur në dispozicion për Autoritetin Publik për kthimin e përgjigjes, në kundërshtim kjo me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilën përcaktohet se: “1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe”.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikohet se: “Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.”

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 892 Prot., datë 28.04.2022 të znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Kulturës”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 29 . 4 .2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

